



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

UDHËZUES PËR PRAKTIKA TË MIRA TRAJTIMI I RASTEVE TË PERSONAVE LGBTIQ+

Prishtinë

| | |
|---|----|
| I. Hyrje | 3 |
| Qëllimi i Udhëzuesit | 3 |
| Konteksti i çështjeve të personave LGBTIQ+ | 3 |
| 1. Përshkrimi i personave që janë pjesë e komuniteteve LGBTIQ+ në Kosovë | 3 |
| 1.1. Diskriminimi ndaj personave LGBTIQ+ në Kosovë | 3 |
| 1.2. Ndikimi i kulturës dhe i traditave në diskriminimin ndaj personave LGBTIQ+ në Kosovë | 4 |
| 1.3. Ndërgjegjësimi dhe pranimi i personave LGBTIQ+ në Kosovë..... | 4 |
| 1.4. Ndryshimi i ligjeve dhe i politikave në lidhje me personat LGBTIQ+ në Kosovë..... | 4 |
| 1.5. Dhuna ndaj personave LGBTIQ+ në Kosovë | 4 |
| 2. Rëndësia e ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe që respektojnë dinjitetin për personat LGBTIQ+ | 5 |
| II. Kuptimi i identiteteve LGBTIQ+ | 6 |
| 1. Përmbledhje e identiteteve LGBTIQ+ të zakonshme | 6 |
| 2. Terminologjia dhe përdorimi i gjuhës | 7 |
| 3. Mitet dhe stereotipat për t'u shmangur | 7 |
| III. Korniza ligjore dhe politikat | 9 |
| 1. Përmbledhje e së drejtës ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e personave LGBTIQ+ | 9 |
| 2. Përmbledhje e kornizës ligjore vendore që mbrojnë të drejtat e personave LGBTIQ+ | 10 |
| Kushtetuta | 10 |
| Legjislacioni | 11 |
| 3. Roli i Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTIQ+ | 11 |
| 4. Procedura në Institucionin e Avokatit të Popullit për ankesat e personave LGBTIQ+ | 12 |
| 5. Kryerja e intervistave fillestare me në qendër ankuesin/ankuesen | 13 |
| VI. Ofrimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse për personat LGBTIQ+ | 16 |
| 1. Krijimi i një mjedisi përfshirës dhe mikpritës..... | 16 |
| 2. Sigurimi i privatësisë dhe i konfidencialitetit | 16 |
| 3. Komunikimi efektiv me personat LGBTIQ+..... | 17 |
| 4. Trajtimi i sjelljes diskriminuese nga palët e tjera ose zyrtarët e tjerë | 17 |
| V. Trajnim dhe zhvillim i zyrtarëve | 18 |
| 1. Rëndësia e trajnimit të vazhdueshëm dhe i zhvillimit profesional të zyrtarëve | 18 |
| 2. Ofrimi i mjeteve dhe i burimeve për punën me personat LGBTIQ+ | 18 |
| 3. Promovimi i një kulture gjithëpërfshirëse brenda vendit të punës | 19 |
| VI. Bashkëpunimi me organizatat e komuniteteve LGBTIQ+ | 19 |
| 1. Zhvillimi i partneriteteve me organizatat e komuniteteve LGBTIQ+ | 20 |
| 2. Kuptimi i nevojave dhe i shqetësimeve të komuniteteve LGBTIQ+ | 20 |
| 3. Përfshirja e komuniteteve LGBTIQ+ në zhvillimin dhe vlerësimin e shërbimeve | 20 |
| VII. Monitorimi dhe vlerësimi | 20 |
| VIII. Përfundim | 21 |

I. Hyrje

Qëllimi i Udhëzuesit

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ofrojë praktika të mira për zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë në lidhje me trajtimin e personave LGBTIQ+ gjatë procedurës së pranimit dhe trajtimit të ankesave. Ky Udhëzues do t'i ndihmojë zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit në ofrimin e shërbimeve profesionale, cilësore dhe të përshtatshme për personat LGBTIQ+, duke u fokusuar në trajtimin me dinjitet si dhe nevojat dhe sfidat e tyre specifike.

Përmes këtij udhëzuesi, zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit do të marrin informacione dhe njohuri të nevojshme në lidhje me sfidat që përballen personat LGBTIQ+ në Kosovë dhe do të marrin udhëzime praktike për t'i trajtuar ata/ato me dinjitet, ndjeshmëri, respekt dhe profesionalizëm.

Gjithashtu, Udhëzuesi synon t'i inkurajojë dhe t'i ndihmojë institucionet e tjera publike për të ofruar shërbime më të mira dhe më të ndjeshme ndaj personave LGBTIQ+. Në këtë mënyrë, Udhëzuesi do të ndihmojë në promovimin e respektimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të personave LGBTIQ+ në të gjitha sferat e shoqërisë në Kosovë.

Konteksti i çështjeve të personave LGBTIQ+

1. Përshkrimi i personave që janë pjesë e komuniteteve LGBTIQ+ në Kosovë

Komunitetet LGBTIQ+ në Kosovë përbëhen prej personave që kanë orientim seksual dhe identitet gjinor të ndryshëm nga normat heteronormative shoqërore. Për shkak të diskriminimit dhe stigmatizimit me të cilin ballafaqohen personat LGBTIQ+ në baza ditore, ata mund të kenë probleme në marrjen e shërbimeve që ofrohen nga autoritetet publike dhe nga sektori privat, si dhe kanë vështirësi në realizimin e të drejtave dhe të lirive të tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me kornizën ligjore në fuqi.

1.1. Diskriminimi ndaj personave LGBTIQ+ në Kosovë

Diskriminimi ndaj personave LGBTIQ+ është një problem i përgjithshëm në Kosovë. Këta persona mund të përballen me diskriminim në vendin e punës, qasjen në shërbimet publike, në shoqëri dhe në familje. Diskriminimi ndaj personave LGBTIQ+ mund të çojë në vështirësi në realizimin e të drejtave dhe të lirive të tyre, si dhe në marrjen e shërbimeve.

Shembull hipotetik i diskriminimit në fusha të ndryshme të jetës

Një person LGBTIQ+ në Kosovë aplikoi për një punë në një kompani private, por në momentin e intervistës së punës, u pyet nëse ishte i martuar dhe nga ai u kërkua që të ndërrojë imazhin e tij, për shkak të orientimit të tij seksual. Kandidati nuk u pranua në punë.

Këtu, personi LGBTIQ+ u diskriminua për shkak të orientimit të tij seksual dhe iu pamundësua mundësia e barabartë për qasje në punësim. Për pasojë, kjo mund të ndikojë në marrjen e shërbimeve dhe gëzimin e të drejtave të barabarta në shoqëri, si dhe në nivelin personal të

kandidatit. Personi mund të ndihet i izoluar dhe të humbasë besimin në vetvete, ndërsa edhe shoqëria mund të pësojë për shkak të mungesës së diversitetit dhe tolerancës në vendin e punës.

1.2. Ndikimi i kulturës dhe i traditave në diskriminimin ndaj personave LGBTIQ+ në Kosovë

Kosova është një vend ku normat kulturore dhe tradita kanë ndikim të madh. Për shkak të ndikimit të kulturës dhe të traditave, disa njerëz në Kosovë e shohin homoseksualitetin dhe identitetin gjinor si diçka që është jashtë normave shoqërore dhe kjo mund të çojë në diskriminim ndaj personave LGBTIQ+.

Shembull i ndikimit të kulturës dhe të traditës

Një person transgjinor në Kosovë ka përjetuar diskriminim në punë. Personi u refuzua nga një pozitë në një kompani pas intervistës, me arsyetim se kompania nuk ka nevojë për "njerëz të tillë". Përveç kësaj, personi kishte përjetuar edhe diskriminim në familje, ku prindërit e refuzonin identitetin e tij/saj gjinor dhe e trajtonin si një sëmundje.

Këto eksperiencë të diskriminimit kanë ndikuar në shëndetin dhe mirëqenien emocionale të personit dhe kanë bërë që ai/ajo të ndihet i/e izoluar dhe i/e diskriminuar në shoqëri. Për t'u përballur me këto vështirësi, personi ka kërkuar mbështetje nga organizatat dhe grupet që mbështesin të drejtat e personave LGBTIQ+ në Kosovë.

1.3. Ndërgjegjësimi dhe pranimi i personave LGBTIQ+ në Kosovë

Në Kosovë ka ndodhur një rritje e ndërgjegjësisimit dhe e pranimit të personave LGBTIQ+ në disa fusha të jetës, siç është arti, media dhe shoqëria civile. Edhe pse ky është një progres i rëndësishëm, ende ka shumë punë për t'u bërë në lidhje me pranimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTIQ+ në Kosovë.

1.4. Ndryshimi i ligjeve dhe i politikave në lidhje me personat LGBTIQ+ në Kosovë

Në Kosovë ka pasur ndryshime të rëndësishme në ligjet dhe të politikat që kanë të bëjnë me të drejtat e personave LGBTIQ+. Kjo përfshin Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligjin për Barazinë Gjinore si dhe politikat e ndryshme që mbështesin dhe promovojnë të drejtat e personave LGBTIQ+. Megjithatë, edhe pse ka pasur progres në këtë drejtim, ende ka nevojë për ndryshime dhe përmirësime të mëtejshme në legjislacion dhe në politikat për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e personave LGBTIQ+ në Kosovë.

1.5. Dhuna ndaj personave LGBTIQ+ në Kosovë

Personat LGBTIQ+ në Kosovë janë të ekspozuar ndaj diskriminimit, ngacmimit, dhunës dhe përjashtimit social. Kështu, ata janë viktimë e sulmeve (përmes ushtrimit të dhunës fizike dhe verbale), keqtrajtimit dhe ngacmimit. Për më tepër, si rezultat i dhunës së përjetuar, ata ndihen të izoluar dhe heshtin ndaj traumave të tyre.

Forma më e shpeshtë e dhunës së përjetuar nga personat LGBTIQ+ është dhuna në familje, në veçanti kur identiteti i tyre seksual apo ai gjinor bëhet i ditur apo dyshohet të jetë ndryshe nga normat e paracaktuara shoqërore. Gratë transgjimore janë më të prira të jenë viktimë të ngacmimeve dhe sulmeve seksuale. Personat interseksual janë viktimë e praktikave mjekësore të dhunshme dhe të dëmshme duke filluar nga ndërhyrjet kirurgjike ndaj fëmijëve të vegjël interseksual, deri te paragjykimet e dëmshme ndaj identitetit të tyre gjinor dhe seksual. Personat LGBTIQ+ gjithashtu raportojnë nivele të larta të diskriminimit dhe ngacmimeve në vendin e punës, përfshirë ballafaqimin me komente dhe pyetje të paarsyeshme, fyese dhe denigruese nga mbikëqyrësit dhe kolegët. Anëtarët e komuniteteve LGBTIQ+, që u takojnë edhe grupeve të tjera etnike joshumicë, përballen me shumë forma të marginalizimit dhe të diskriminimit që janë të ndërlikura dhe mund ta shumëfishojnë ndjenjën e pasigurisë.

Dhuna, diskriminimi dhe ngacmimi pengojnë aftësinë e komuniteteve LGBTIQ+ për të qenë pjesë aktive dhe për të kontribuar në shoqëri. Kjo ndikon në rezultatet e tyre sociale, pasi përvojat e diskriminimit dhe ngacmimit në mjedis, si: institucione shëndetësore, shkolla dhe ofruesit e strehimit, kontribuojnë në rezultate të dobëta shëndetësore dhe socio-ekonomike dhe në përjashtimin social në përgjithësi. Është e rëndësishme që autoritetet publike dhe sektori privat të kontribuojnë pozitivisht në mënjanimin e këtyre çështjeve dhe të sigurojnë një mjedis të mbrojtur dhe të sigurt. Në rastet kur personat LGBTIQ+ përballen me diskriminim dhe dhunë është e rëndësishme që institucionet e përfshira të ofrojnë mbështetje dhe ndihmë për ta.

2. Rëndësia e ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe që respektojnë dinjitetin për personat LGBTIQ+

Është e rëndësishme që institucionet publike dhe private të ofrojnë shërbime gjithëpërfshirëse dhe të respektojnë dinjitetin e personave LGBTIQ+. Kjo do të thotë që duhet të mbahet në konsideratë identiteti gjinor dhe orientimi seksual i personave LGBTIQ+ dhe të ofrohet mbështetje dhe ndihmë në mënyrë që të sigurohet që ata të ndihen të mirëpritur dhe të respektuar. Institucionet duhet të kenë një qasje të përgjegjshme dhe të ndjeshme ndaj personave LGBTIQ+ dhe të kenë udhëzime të qarta dhe të pranueshme për trajtimin e tyre.

Personat LGBTIQ+ në Kosovë, gjatë marrjes së shërbimeve publike, përballen me sfida të veçanta, siç janë: diskriminimi, stigmatizimi dhe mungesa e pranimit. Institucionet publike duhet të kenë kujdes të veçantë për të siguruar që këto sfida të tejkalohen dhe që personat LGBTIQ+ të kenë qasje në shërbime të cilat janë profesionale dhe të përshtatshme për nevojat e tyre. Kjo do të përfshijë edhe trajnimin e zyrtarëve të institucioneve për t'i kuptuar më mirë nevojat dhe sfidat me të cilat përballen personat LGBTIQ+ dhe për t'u siguruar që ata të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.

II. Kuptimi i identiteteve LGBTIQ+

1. Përmbledhje e identiteteve LGBTIQ+ të zakonshme

Identiteti gjinor dhe orientimi seksual janë pjesë e identitetit personal të secilit njeri. Personat LGBTIQ+ mund të kenë identitete të ndryshme dhe është e rëndësishme që institucionet të jenë të ndjeshme ndaj këtyre identiteteve dhe t'i trajtojnë ata në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Në përgjithësi, personat LGBTIQ+ mund të identifikohen si:

- ⇒ **Homoseksual (a):** një person i cili ndien ndjenja romantike ose seksuale për personat e gjinisë së njëjtë si vetja.
- ⇒ **(B) Biseksual:** një person i cili ndien ndjenja romantike ose seksuale për persona të të dy gjinive.
- ⇒ **(L) Lezbike:** një grua që është emocionalisht dhe/ose fizikisht e tërhequr ndaj një gruaje tjetër.
- ⇒ **(G) Gej:** një person mashkull që është emocionalisht dhe/ose fizikisht i tërhequr ndaj një personi tjetër mashkull.
- ⇒ **(T) Transgjinor:** një person i cili ka një identitet gjinor që nuk korrespondon me atë të caktuar në lindje, si dhe mund të ketë ndryshuar emrin dhe/ose gjininë e dokumentacionit të tij të identitetit.
- ⇒ **(I) Interseks:** një person që lind me karakteristika të dukshme ose jo fizike, anatomike ose gjenetike, që nuk përcaktohen si tipike të femrës ose mashkullit, duke përfshirë trupin, organet gjentiale, sistemin riprodhues dhe/ose hormonet.
- ⇒ **(Q) Queer:** një term i përgjithshëm që përdoret nga disa persona LGBTIQ+ për t'u përshkruar si jonormativ, dhe që mund të përfshijë ndonjë nga identitetet e mësipërme, apo identitete të tjera.
- ⇒ **Seksi:** nënkupton karakteristikat biologjike dhe fiziologjike, të cilat përcaktojnë meshkujt dhe femrat.
- ⇒ **Gjinia:** nënkupton role të krijuara shoqërore, të cilat i atribuohen femrave dhe meshkujve, që është identitet i fituar që mësohet, pëson ndryshime me kalimin e kohës dhe ndryshon përgjithësisht brenda dhe ndërmjet kulturave.
- ⇒ **Identiteti gjinor:** kjo karakteristikë e mbrojtur mbulon identitetin që ka të bëjë me gjininë e një personi, dukjen apo karakteristikat e tjera që lidhen me gjininë e një personi (qoftë përmes ndërhyrjes kirurgjike apo jo) duke mos marrë parasysh seksin që personi e ka pasur në lindje.

⇒ **Orientimi seksual:** orientimi seksual është një term që përshkruan ndjenjat ose tërheqjen emocionale dhe/ose fizike të një personi ndaj tjetrit, që zakonisht kategorizohet si heteroseksual, homoseksual, biseksual etj.

2. Terminologjia dhe përdorimi i gjuhës

Përdorimi i terminologjisë së duhur është thelbësor për të kuptuar dhe trajtuar me respekt personat LGBTIQ+. Institucionet publike dhe zyrtarët duhet ta kuptojnë terminologjinë dhe të sigurojnë se ata po përdorin gjuhën e duhur për të përshkruar identitetet dhe orientimet e ndryshme seksuale. Në këtë mënyrë është e rëndësishme që zyrtarët ta kuptojë diferencën midis termave të zakonshëm, si: homoseksualiteti; dhe termave më të rinj, si: panseksualiteti dhe asseksualiteti.

Është gjithashtu e rëndësishme të kuptojmë që terminologjia dhe identitetet LGBTIQ+ mund të ndryshojnë nga një person në tjetrin dhe mund të jenë subjektive. Ndërsa termat e lartpërmendur përdoren në shumë vende, ndoshta në Kosovë mund të ketë edhe terma të tjerë të cilët përdoren nga personat LGBTIQ+. Kuptimi i kësaj terminologjie dhe përdorimi i saj në mënyrë korrekte dhe respektuese është thelbësor për të krijuar një mjedis gjithëpërfshirës dhe të sigurt për personat LGBTIQ+.

Nëse nuk jeni i sigurt për përdorimin e një termi të caktuar, ju duhet të jeni të hapur për t'i pyetur personat LGBTIQ+ si preferojnë të përshkruhen dhe të identifikohen. Kjo do të tregojë një nivel respekti dhe kujdesi të veçantë ndaj tyre.

3. Mitet dhe stereotipat për t'u shmangur

Autoritetet publike dhe zyrtarët e IAP-së duhet t'i shmangin mitet dhe stereotipat e zakonshëm për personat LGBTIQ+. Në vend se të kujdesen për klasifikime në bazë të stereotipave, ata duhet të kenë një qasje të ndjeshme ndaj palës që i përket ndonjërit nga komunitetet LGBTIQ+. Mitet dhe stereotipat janë ide të gabuara dhe shpesh të dëmshme që rrethojnë personat LGBTIQ+. Në vend se të përqendrohen në këto ide, zyrtarët e IAP-së dhe institucionet publike duhet të bëjnë përpjekje që personat LGBTIQ+ t'i trajtojnë me respekt dhe dinjitet. Disa nga mitet dhe stereotipat më të zakonshëm që duhet të shmangen, janë:

Mit: "Homoseksualiteti është një zgjedhje dhe mund të ndryshohet".

Realitet: Homoseksualiteti është një orientim seksual dhe asnjë person nuk zgjedh të jetë. Në të vërtetë, homoseksualiteti është një pjesë e identitetit të personit dhe nuk mund të ndryshohet.

Stereotip: "Të gjithë personat LGBTIQ+ kanë një identitet të njëjtë".

Realitet: Personat LGBTIQ+ janë të ndryshëm dhe kanë identitete individuale, siç ndodh me çdo person tjetër. Në fakt, personat LGBTIQ+ mund të kenë identitete, si: homoseksual, biseksual, transgjinnor etj.

Mit: "Personat transgjinnor kanë shpesh probleme emocionale dhe duhen trajtuar si pacientë psikiatrikë".

Realitet: Identiteti gjinor nuk është sëmundje mendore. Identiteti gjinor i një personi është pjesë e shpërndarjes normale të identiteteve të njerëzve.¹

Stereotip: Biseksualët janë të paqëndrueshëm dhe nuk mund të vendosin nëse duan një partner burrë ose grua.

Realitet: Biseksualiteti është një orientim seksual në të cilin një person ndien tërheqje seksuale ndaj personave të të dy gjinive. Biseksualët mund të kenë një partner burrë ose grua dhe nuk kanë nevojë për të vendosur midis këtyre dy opsioneve.

Mit: Personat LGBTIQ+ janë më shumë të prirë për t'u infektuar nga infeksionet seksualisht të transmetueshme.

Realitet: Infeksionet seksualisht të transmetueshme nuk janë të lidhura me orientimin seksual apo identitetin gjinor. Personat LGBTIQ+ mund të kenë rrezik të njëjtë sa edhe personat e tjerë, që janë seksualisht aktiv, për t'u infektuar me infeksionet seksualisht të transmetueshme dhe duhet të mbrohen në të njëjtën mënyrë.

Mit: Personat LGBTIQ+ nuk mund të kenë fëmijë dhe nuk janë familjarë.

Realitet: Personat LGBTIQ+ kanë të njëjtin potencial si çdo person tjetër për të qenë prindër dhe të formojnë familje të shëndetshme dhe të bazuar në dashuri. Për shembull, çiftet homoseksuale mund të ushqejnë dhe të rrisin fëmijë në mënyra të shëndetshme dhe të kenë përkujdesje maksimale ndaj tyre. Ka shumë studime që tregojnë se fëmijët që rriten në familjet homoseksuale kanë shëndet të mirë dhe arrijnë rezultate të mira në shkollë dhe karrierë.²

Stereotip: Personat LGBTIQ+ janë më shumë të prirë të jenë përdorues të drogave.

Realitet: Ky stereotip nuk qëndron, është i padrejtë dhe i dëmshëm. Në fakt, nuk ka asnjë lidhje midis orientimit seksual dhe përdorimit të drogave. Ky stereotip është rezultat i diskriminimit dhe i stigmatizimit të personave LGBTIQ+, që mund të çojë në manifestimin e sjelljeve të rrezikshme si pasojë e ndjesisë së të qenit të izoluar dhe të pashoqëruar. Është e rëndësishme që personat LGBTIQ+ të trajtohen me respekt dhe të mbështeten në mënyra pozitive, duke ndihmuar në zbutjen e diskriminimit dhe të stigmatizimit të tyre.

¹ Edicioni i pestë i Manualit Diagnostik dhe Statistikor të Çrregullimeve Mendore (DSM-5) ka ndryshuar kategorinë e "Çrregullimit të Identitetit Gjinor" duke e zëvendësuar me "Dysforinë Gjinore", në vitin 2013. Ky ndryshim reflekton një ndryshim të thellë në mënyrën se si shkencat mendore dhe mjekësore e konsiderojnë identitetin transgjinor - jo si një çrregullim mendore, por si një pjesë e shpërndarjes normale të identiteteve të njerëzve.

² Promoting the Well-Being of Children Whose Parents Are Gay or Lesbian, The American Academy of Pediatrics, Policy Statemen, April 01, 2013, i qasshëm në: <https://publications.aap.org/pediatrics/article/131/4/827/31789/Promoting-the-Well-Being-of-Children-Whose-Parents?autologincheck=redirected>.

Definicion

Mitet dhe stereotipat janë bindje të gabuara, të pabazuara, ose ide të pavërteta që njerëzit kanë në lidhje me një grup njerëzish, duke i konsideruar ato si të vërteta pa bërë vlerësime të arsyeshme dhe të bazuara në fakte. Këto ide, edhe pse nuk janë të vërteta, mund të kenë një ndikim të madh në mënyrën se si një grup i caktuar njerëzish trajtohet në shoqëri jo vetëm nga entitetet private, por edhe nga institucionet publike. Shpesh këto ide të pavërteta janë të ndërthurura me diskriminim dhe mund të ndikojnë në të drejtat dhe rrethanat jetësore të njerëzve, të cilët i përkasin këtyre grupeve.

III. Korniza ligjore dhe politikat

1. Përmbledhje e së drejtës ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e personave LGBTIQ+

Në nivelin ndërkombëtar, të drejtat për barazi dhe mosdiskriminim janë parimet kryesore të të drejtave të njeriut, të mbrojtura me Kartën e Kombeve të Bashkuara, me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDN) dhe me instrumentet e tjera për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, në hyrje përcakton: *“Të gjithë qeniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta në dinjtet dhe të drejta.”* Garancia e barazisë dhe e mosdiskriminimit, të siguruara nga e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, aplikohet për të gjithë njerëzit, pavarësisht gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, ose ndonjë “statusi” tjetër. Nuk ka asnjë tekst, asnjë paragraf të fshehur, në asnjë traktat apo instrument të të drejtave të njeriut që lejon një shtet të garantojë të drejta të plota për disa dhe të mos i garantojë ato për disa të tjerë, vetëm për shkak të orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor.

Për më tepër, mekanizmat mbikëqyrës të të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara kanë konfirmuar se orientimi seksual dhe identiteti gjinor janë përfshirë në mesin e bazave të mbrojtura për të cilat ndalohet çdo formë e diskriminimit nën të drejtën ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë se është e ndaluar të bëhet ndonjë dallim midis të drejtave të njeriut në bazë të faktit se ata janë: lezbike, homoseksualë, biseksualë, ose transgjinorë, ashtu siç është e ndaluar të bëhet dallim në bazë të ngjyrës së lëkurës, racës, gjinisë, besimit, ose çdo statusi tjetër personal. Ky pozicion është konfirmuar herë pas here në vendimet dhe në udhëzimet e përgjithshme të këtyre mekanizmave, si: Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve, Komiteti Kundër Torturës, dhe Komiteti për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave.

Në nivelin evropian, parimi i mosdiskriminimit bazuar në orientimin seksual dhe në identitetin gjinor referohet në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në Konventën për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në rekomandimet e Komitetit të Ministrave, te Komisionari

për të Drejtat e Njeriut dhe në organet të tjera të Këshillit të Evropës. Këto instrumente ndalojnë diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor dhe njihen si parime themelore të drejtave të njeriut në Evropë. Në të njëjtën mënyrë, mekanizmat e monitorimit të Këshillit të Evropës kanë bërë thirrje për të garantuar respektimin e të drejtave të personave LGBTIQ+ në shtetet anëtare të tyre, duke ua rikujtuar atyre për obligimet ndaj Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në përfundim, duhet theksuar se garantimi i të drejtave të personave LGBTIQ+ është një pjesë thelbësore e të drejtave të njeriut dhe se është përgjegjësi e çdo shteti t'i respektojë, t'i mbrojtë dhe t'i promovojë të drejtat e njeriut pa diskriminim në çfarëdo baze.

2. Përmbledhje e kornizës ligjore vendore që mbron të drejtat e personave LGBTIQ+

Kushtetuta

Si një demokraci kushtetuese, vlerat kushtetuese të Kosovës përfshijnë barazinë, respektin për të drejtat e njeriut dhe mosdiskriminimin, që përçon një porosi të qartë se të gjithë qytetarët e saj duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, të drejtat e tyre njerëzore të respektohen pa diskriminim.³ Vlerat e tilla janë të përfshira në të drejtat kushtetuese, si: Barazia para Ligjit - që ofron trajtim të barabartë para ligjit për të gjithë dhe që secili gëzon të drejtën për mbrojtje të barabartë pa diskriminim.⁴ Për më tepër, Kushtetuta thekson se askush nuk mund të diskriminohet në bazë të një sërë karakteristikash, përfshirë këtu edhe gjininë apo statusin personal.

Të drejtat e njeriut dhe ato kushtetuese përbrenda sistemit juridik kombëtar janë fuqizuar më tej duke bërë të zbatueshme drejtpërdrejt instrumentet dhe marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, siç është, ndër të tjerash, edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj).

Në rast të dispozitave kundërrhënëse në fushën e të drejtave të njeriut ndërmjet masave në nivel kombëtar me të drejtat e mbrojtura me këto marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare, këto të dytat mbizotërojnë.⁵ Një aspekt tjetër i rëndësishëm i kuadrin kushtetues është interpretimi i të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim Kushtetuta parasheh që të drejtat dhe liritë fundamentale, të garantuara me Kushtetutë, duhet të interpretohen në përputhshmëri me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj).

Përderisa Kushtetuta nuk i referohet specifikisht transgjitorëve apo identitetit gjinor, ajo ofron kornizë të rëndësishme, përmes së cilës mund të argumentohet se të drejtat e personave transgjitorë janë të mbrojtura. Së pari, Kushtetuta parasheh se të gjithë personat gëzojnë të drejtën e mbrojtjes ligjore pa diskriminim dhe kjo përfshin edhe personat transgjitorë. Në rastet kur një ligj nuk parasheh mbrojtje të tillë të barabartë, mund të argumentohet se kjo është në kundërshtim me atë që parasheh Kushtetuta. Së dyti, ndalimi i diskriminimit duke iu referuar gjinisë apo ndonjë statusi tjetër personal ofron hapësirë për interpretim të tillë që të nënkuptojë ndalimin e

³Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 7 (1).

⁴Po aty, Neni 24 (1).

⁵Po aty, Neni 22.

diskriminimit në bazë të identitetit gjinor. Së treti, interpretimi i të drejtave të garantuara me Kushtetutë duhet të bëhet në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe në mënyre konsistente me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj). Praktika e GjEDNj-së në shumë raste ka konstatuar se identiteti gjinor është karakteristikë e mbrojtur dhe e njëjta praktikë ofron fushëveprim më të gjerë për mbrojtjen e të drejtave të personave transgjinorë në Kosovë.

Legjislacioni

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Një nga pjesët kyçe të legjislacionit, që është relevant për sigurimin e mbrojtjes adekuate të identitetit gjinor dhe orientimit seksual, është Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ky ligj ndalon diskriminimin, ndër të tjera, edhe në bazë të orientimit seksual, seksit, gjinisë apo identitetit gjinor⁶ dhe siguron që personat LGBTIQ+ të jenë të mbrojtur me dispozitat e kësaj pjese të legjislacionit.

Zbatimi i këtij ligji është i rëndësishëm së veçantë, pasi mbulon veprimet apo lëshimet e të gjitha institucioneve shtetërore, personave fizikë dhe atyre juridikë, në sektorin publik dhe në atë privat. Kështu që jo vetëm institucionet qeveritare ose ndërmarrjet publike duhet të sigurohen që të veprojnë në pajtim me ligjin, por edhe kompanitë private janë njësoj përgjegjëse. Për më tepër, ndalimi aplikohet ndaj një game të gjerë të fushave, si: punësim (duke përfshirë qasjen, kushtet, promovimin etj.), trajnime dhe udhëzime profesionale, mbrojtje sociale (përfshirë asistencën sociale, sigurimin social dhe mbrojtjen shëndetësore), përparësitë sociale, arsim, qasje në vendbanim, qasje dhe furnizim në të mira materiale dhe shërbime të cilat janë në dispozicion për publikun, trajtim të drejtë dhe të barabartë para organeve gjyqësore, të drejtë pjesëmarrjeje në shkencë dhe kulturë, siguri personale, pjesëmarrje në çështjet publike, qasje në vendet publike, dhe çfarëdo të drejte tjetër e paraparë me legjislacionin në fuqi.⁷

Ligji për Barazinë Gjinore

Ligji për Barazinë Gjinore⁸ mbron dhe promovon barazinë midis gjinive si një vlerë themelore të një shoqërie demokratike.⁹ Ky ligj aplikohet për burra, gra dhe persona që kanë një karakteristikë të mbrojtur të identitetit gjinor ose të përcaktimit të gjinisë dhe garanton mundësi dhe trajtim të barabartë në sferën publike dhe private të jetës shoqërore.¹⁰

3. Roli i Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTIQ+

Avokati i Popullit në Kosovë është institucion i pavarur kushtetues, që ka për detyrë t'i mbrojtë, t'i promovojë dhe t'i mbikëqyrë të drejtat dhe liritë e njeriut. Kjo nënkupton se Avokati i Popullit ka

⁶Neni 1, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

⁷Po aty, Neni 2.

⁸Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore.

⁹Po aty, Neni 1 (1).

¹⁰Po aty, Neni 2 (2).

një rol të rëndësishëm në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve LGBTIQ+ në Kosovë.

Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit në Kosovë, Avokati i Popullit është mekanizëm ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe të lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, të institucioneve dhe të personave apo të autoriteteve të tjera që ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës. Kjo përfshin edhe shkeljet e të drejtave të personave LGBTIQ+.

Avokati i Popullit mund të ndërmarrë hetime dhe të japë rekomandime për autoritetet për t'i evituar shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore. Ai gjithashtu mund t'i promovojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore nëpërmjet publikimeve, takimeve publike dhe fushatave të ndryshme të ndërgjegjësimit.

Në këtë kontekst, Avokati i Popullit mund t'i mbrojë dhe t'i promovojë të drejtat e personave LGBTIQ+ në Kosovë, në shumë mënyra, duke përfshirë:

- hetimin e ankesave të personave LGBTIQ+ dhe, në rast të vlerësimit se janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut, publikon raport me rekomandime për evitimin e shkeljeve të konstatuara;
- organizimin e takimeve dhe të fushatave të ndërgjegjësimit për t'i promovuar të drejtat e personave LGBTIQ+ dhe për pranimin dhe respektimin e tyre në shoqëri;
- përpilimin e raporteve sipas detyrës zyrtare dhe publikime të tjera që përmbajnë informacione të rëndësishme në lidhje me të drejtat e personave LGBTIQ+ për gjendjen e tyre në Kosovë;
- rekomandime për plotësim-ndryshim të ligjeve dhe të politikave publike, që ndikojnë në të drejtat e personave LGBTIQ+ dhe përkrahjen e ndryshimeve pozitive në këtë fushë;
- ofrimin e këshillave për personat LGBTIQ+ që kanë pasur shkelje të të drejtave të tyre në lidhje me diskriminimin, përndjekjen, dhunën apo abuzimin.

Për t'i realizuar këto detyra, Avokati i Popullit duhet të ketë qasje të hapur dhe gjithëpërfshirëse ndaj të drejtave të personave LGBTIQ+.

4. Procedura në Institucionin e Avokatit të Popullit për ankesat e personave LGBTIQ+

Në bazë të Ligjit për Avokatin e Popullit të Republikës së Kosovës, personat LGBTIQ+ kanë të drejtë të paraqesin ankesa nëse ata besojnë se të drejtat e tyre të ligjshme janë shkelur nga një autoritet publik në Kosovë.

Të gjitha veprimet e mëtejme të Institucionit të Avokatit të Popullit për trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave do të ndërmerren në pajtim me Ligjin për Avokatin e Popullit, me rregulloret dhe me procedurat e brendshme.

Në rastin e personave LGBTIQ+, sikur edhe për palët e tjera, procesi fillon kur një person LGBTIQ+ paraqet një ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit. Në këtë ankesë, personi duhet ta përshkruajë në mënyrë të hollësishme shkeljen e të drejtave të tij ose të saj dhe të tregojë se si institucioni publik ka kontribuar në këtë shkelje. Në rastin e diskriminimit, edhe shkeljet nga personat privatë, këshillohet për adresim të ankesës te autoritetet përkatëse. Ankesa mund të paraqitet përmes pranisë fizike, përmes postës, ose mund të paraqitet në mënyrë elektronike.

Pas pranimit të ankesës, zyrtarët e Avokatit të Popullit do të bëjnë një vlerësim paraprak për të vendosur nëse plotësohen kushtet ligjore për pranimin e ankesës për të vazhduar me hetimet. Nëse vendoset të vazhdohet shqyrtimin e ankesës, do të merren informacione shtesë nga institucioni publik lidhur me shkeljet e pretenduara nga ankuesi.

